

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

ALVA DANI

DISA ELEMENTE ETNOKULTURORE TË LAHUTËS NË VARIANTIN ITALISHT

Studimet e ndryshme mbi përkthimin janë ndezur shpeshherë edhe nga debatet që lidhen me të ashtuquajturën vështirësi të përkthimit të poezisë, edhe për shkak të polisemisë së ligjërimit poetik. Çdo fjalë a pjesëz, sado e vogël, përmban një ngarkesë konotative, që është vështirësisht e transferueshme në një gjuhë tjetër. Jurij Lotman do të shkruante: “Vështirësitë kryesore të përkthimit të një teksti letrar janë të lidhura ... me nevojën e transmetimit të lidhjeve semantike që krijohen, në veçanti në tekstin poetik...”¹. Vështirësitë e mëdha që ndeshen në përkthimin poetik i detyrohen faktit se nivelet e ligjërimit si për shembull niveli metriko-ritmik, niveli semantiko-leksikor, niveli fonologjik dhe ai sintaksor, janë jo vetëm mbartës të kuptimit, por dhe sidomos janë të lidhur ngushtë mes tyre, aq sa ndryshimet në brendësi të njërit reflektohen menjëherë tek të tjerët. Në këto nivele mund të trajtojmë në mënyrën e duhur edhe përkthimin e *Lahutës së Malësisë* në gjuhën italiane, e cila do të kërkonte një studim të gjerë e të detajuar.

Një aspekt i këtij përkthimi, të cilin do ta veçojmë për këtë punim është dhe elementi etnokulturor, tepër i rëndësishëm, i cili do të përbënte edhe një kolonë të rëndësishme studimi për shumë studiues të *Lahutës*. Kjo për faktin se vetë Lahuta është një pasuri e vërtetë, e madhe e traditës dhe kulturës së popullit tonë shqiptar, “Malsinat e Veriut - shkruan studiuesi Tahir Kolgjini - kishin trashigë doke e zakone të gjana prej stërgjyshave të tyre illirianë; zakone, të cillat ishin përpunue me një mjeshtri shumë të hollë. Dhe çdokush, ishte i shtërnguem që t’i nderojë fillë e për pe; se për ndryshe, nuk kishte vend me qëndrue në gjinin e shoqnis shqiptare malsore. Këto zakone, ishin lidhun si verigat mbas njana tjetrës;...”².

Kësaj jete të ashpër e të vështirë mes bjeshkëve të mëdha e pyjeve të dendura, mes kodrave të larta e luginave të thyeshme, në logun e betejave të përgjakshme e mësymjeve të vazhdueshme nuk do të mund t’i rezistonte as Ernest Koliqi. Si studiues e njohës shumë i mirë i poezisë popullore shqipe, si përkthyes i shumë klasikëve italianë, si njohës i shkëlqyer i të dy gjuhëve nuk kishte se si të mos joshej edhe nga vargjet brilante, të shkruara në gegërishten e malësisë së veriut, nga klasiku shqiptar.

Fishta shpreh vlerësim për përkthimet e Koliqit e në një parathënie të Poetëve të mëdhenj të Italisë, ai shkruan: “... duhet me zotnue mirë të dyja gjuhët e ma tepër përkthyesi me pasë shkndin poetike në vedi: si asht rasa me thanë për Z.

¹ Lotman, *Il problema del testo poetico*, in A.A.V.V. *Teorie contemporanee di traduzione*, a cura di S. Nergaard, Milano, Bompiani, 1995, f. pag. 260.

² T. Kolgjini, *Shpalime rreth Lahutës*, Istanbul, 1969, f. VIII.

Koliqin t'onë, i cilli, posë se ka në vedi shkndin poetike, zotnon edhe ma së miri gjuhën shqype e italishte, sikur diftojnë veprat qi der m'sot ka botue"³. Ai i hyri përkthimit të *Lahutës*, nga ku përktheu vetëm këngët II, III, IV dhe V nga episodi i Oso Kukës dhe këngët XII, XIII, XIV dhe XV nga episodi i Marash Uçit. Një pjesë e vështirë e këtij përkthimi lidhet pikërisht me elementet e traditës shqiptare, se si ata mund të përçohen në një kulturë tjetër, në një mentalitet tjetër, në një tjetër strukturë gjuhësore. Përkthimi, - shkruan Pageaux - është shprehja e diferencave gjuhësore letrare mes dy kulturave: me përkthimin duhet të pranojmë që një tekst rishfaqet në pasqyrën e një gjuhe, e një kulture të huaj... por kjo pasqyrë, duke qenë e huaj, mund të reflektojë më shumë se një imazh besnik, një imazh të ndryshëm"⁴.

Në këtë vështirësi Koliqin e ndihmuan studimet e gjata për rapsodinë e rapsodët, kërkimet e thella deri në terrenet e thepisura të bjeshkëve, nga ku edhe buronte shprehja lakonike malësore. Në gjuhën italiane do të vinte në një formë tjetër, që nuk është e traditës sonë, vargu klasik italian njëmbëdhjetërokësh do të ishte metri i Koliqit përmes të cilit do të përkthente tetërokëshin shqiptar. Kjo qartësisht do të ndikonte edhe në nivelin ritmik, semantik e sintaksor të poemës. Njëmbëdhjetërokëshi është vargu *per eccellenza* i italianëve, i traditës letrare dhe gjuhësore, i klasikëve të mëdhenj të Italisë. Kjo do të sillte ndryshime jo rrallë herë edhe në brendinë e tekstit, në elementet e stilit, e madje edhe në shprehësinë e fjalëve a shprehjeve fishtiane. Duke qenë se është një varg më i gjatë kërkon edhe një numër më të madh fjalësh dhe rrokjesh: Kështu për shembull në episodin e Oso Kukës vërejmë:

- | | |
|--|---|
| 1. T'bjaj qi t'kja jë e zeza nanë:
T'bjaj qi t'kja jë <u>pa "exhel"</u> ty nana;
..... | che su te lagrimar faccio tua madre,
la faccio lagrimar <u>prima del giorno</u>
<u>Segnato dal destino al tuo trapasso.</u> |
| 2. Zot, ç'ka thanë njaj Avdi Pasha:
..... | <u>Che dice</u> Avdi pascià, mio Dio, <u>che dice</u> ? |
| 3. Kshtû ankoi Pasha turceli.
Oso Kuka paska ndi:
paska ndi e kenka idhnue. | Si lamentò in tal guisa il pascià turco.
Oso Kuka ne udì <u>l'aspra rampogna</u> ,
<u>L'aspra</u> ne udì <u>rampogna</u> e si adirò |
| 4. Veshë e mbathë e n'armë shtrengue
..... | Signorilmente vestito e calzato
<u>Fra il luccicchio delle armi ch'egli porta</u> |

Por nuk mendoj se njëmbëdhjetërokëshi mbetet arsyeja e vetme e një përkthimi të tillë. Koliqi sigurisht që e ka menduar mirë këtë variant përkthimi, që ngjan më shumë me një interpretim sesa me një përkthim besnik e të drejtpërdrejtë. Mbase përkthyesi e ka gjykuar të nevojshme për lexuesin e huaj italian të shtonte fjalë e shprehje, të shpjegonte dhe të sqaronte brenda vargjeve

³ Gj. Fishta, *Parathane*, në Poetët e mëdhej t'Italis, Nikaj, Tiranë, 1932, f. XVI.

⁴ D. H. Pageaux, *La traduzione nello studio delle letterature comparate* in "Testo a Fronte", n° 24, I semestre 2001, f. 50.

Disa elemente etnokulturore të *Lahutës* në variantin italisht

fenomene shqiptare, rite, zakone, gjendje shpirtërore, të cilat do të vinin të pakuptimta në formën e tyre origjinale. Sipas teorisë së përkthimit dy do të ishin variantet e përkthimit të një teksti letrar, njëri i orientuar drejt burimit, që synon t'i afrohet sa më shumë veprës origjinale, që të mund të transmetojë shpirtin e saj; tjetri drejt destinacionit, që synon t'i komunikojë lexuesit të huaj kuptimin më të mirë të mundshëm të veprës origjinale në funksion të kulturës së saj kombëtare⁵.

Mesa duket Koliqi mbështetet në variantin e dytë, duke e konsideruar si tepër të rëndësishme, madje thelbësore, njohjen e kulturës dhe traditës së popullit e kombit të tij përmes kësaj poeme. Këtë e shohim qartë tek vargjet e mësipërme, ku fjala turke "*exhel*" përkthehet gati me një fjali të tërë "*prima del giorno segnato dal destino al tuo trapasso*", duke e shpjeguar gjerësisht këtë fjalë që sigurisht mbart një vlerë të caktuar në mentalitetin shqiptar, duke e sqaruar me disa fjalë që pothuajse përkufizojnë kuptimin e saj, duke mos preferuar një fjalë të vetme ose edhe mbase duke mos e gjetur ekuivalenten e saj në italisht.

Të njëjtën teknikë përkthimi ndjek edhe në disa raste të tjera si me fjalën "*caruqe*", të cilat janë opinga të përdorura në jug të gadishullit ballkanik, me karakteristika të veçanta për secilin shtet, e që përkthehet me një fjali shpjeguese dhe jo me një fjalë tjetër të përafërt "*con quei bianchi calzari tuoi di corda*". Përveç këtij vargu që përkton me fjalën *caruqe*, shohim në fund të episodit shënime të tjera shtesë në lidhje me këtë fjalë, me formën dhe elementet e veçanta që dallojnë *caruqet* shqiptare nga ato malazeze. Shënimet vijnë në gjuhën italiane dhe sqarojnë momente të caktuara poetike, të cilat lidhen më së shumti me referime historiko-geografike apo etno-kulturore.

Vargu tjetër "*t' mos t'i majm cubat me vjamë*" përkthehet i shtrirë në dy vargje. Koliqi e gjykon të nevojshëm një shpjegim më të hollësishëm të kësaj ideje, mbase në mënyrë sa më të kuptueshme, më të prekshme e më konkrete për të huajt "*non debbono ingrassar con carne nostra, / col grasso delle capre rapinate*".

Një rast tjetër që shfaq interes është edhe vajtimi i motrës për të vëllanë, Avdinë në këngën e tretë, "Preja". Vaji i saj bëhet edhe më i ethshëm kur ajo ankohet se nuk ka asnjë mashkull që t'i marrë gjakun. Kjo sigurisht që do të ishte vështirësisht e kuptueshme për kulturën dhe qytetërimin italian. Koliqi duke njohur mjaft mirë të dy kulturat ndërhyr në variantin italisht duke shtuar dy vargje me të njëjtin mesazh "*ti piangono oggi, Avdi, due volte morto*" dhe "*prole Avdi, due volte sfortunato*". Kjo i lehtëson pak vargjet "e forta" të Fishta "*Kur ket punë un s'e kam ndi / ... se ka mbetë kund gjak pa u kthye... / a me pare a se me krye...*". Veç vargjeve Koliqi përsëri mendon se është i nevojshëm edhe një sqarim i mëtejshëm mbi këtë fenomen tipik shqiptar, pak e aspak i kuptueshëm për të tjerët. Tek *Note* (Shënime), lexojmë: "... përveçse i vlarë, duke mos patur mashkull tjetër në shtëpi, Avdiu i shkretë do të kishte mbetur i pahakmarrë, dhe

⁵ U. Eco, *Dire quasi la stessa cosa, Esperienze di traduzione*, Milano, Bonpiani, 2003, f. 21: Eco mendon: "përkthimi duhet të më transmetojë sa më mirë të mundet atë që është e shkruar në veprën origjinale".

kjo tepër e rëndë për mentalitetin shqiptar. Do të jetë Oso Kuka, ai që do t'i marrë hakun”.

Nuk është aspak e thjeshtë të përkthesh vargje, e aq më tepër kur ato janë të Fishtës. “Poezia - shkruan Plasari - më shumë se çdo art tjetër ekziston përmjet shenjash të ikshme, nënkuptimesh të rrëshqitshme, ndjelljesh tinzare të emocioneve. Objekti estetik i poezisë nuk gjendet dot kësodore te shtangësia e faqes së shkruar, por tek ajo përmasë e luajtshme e gjithnjë e re në të cilën kryhet, çdo herë, takimi i një teksti me lexues të vet”⁶. Secila fjalë poetike ka ngarkesë të veçantë, ka formë, ka përmbajtje, ka ide e megjithatë ngelet unike, me gjithë natyrën e saj polisemike. Unike sepse është zgjedhje e drejtpërdrejtë e poetit, është mendimi i tij estetik, është thelbi i shpirtit të tij. Prandaj edhe ta përkthesh me shumë përkushtim e me shumë pasion nuk do të ishte asnjëherë e mjaftueshme.

Kështu do t'i referohemi përkthimit të disa fjalëve, të cilat përçojnë shumë më tepër nga kuptimi i tyre i drejtpërdrejtë, fjalë që shpesh shërbejnë si çelës për të kuptuar më thellë vendin dhe jetën e një populli. Kështu për shembull, Fishta sjell një sërë fjalësh që emërtojnë armët e luftimit si: *xheverdare*, *karajfile*, *breshane*, *pushkë*, *calina* e *tagan*. Secila prej tyre ka një formë të caktuar dhe një specifike të vetën. Në përkthimin italisht gjejmë vetëm fjalën *fucile* (pushkë) pa bërë dallime llojesh, me përjashtim vetëm të fjalës *tagan* që e gjejmë përsëri edhe në italisht *yatagan* dhe që nuk është pushkë, por shpatë.

Gjejmë fjalën *dollame*, që sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe do të thotë “veshje e sipërme grash a burrash, zakonisht deri nën gju, ose pothuaj deri tek kyçi i këmbëve dhe e hapur përpara”. Në italisht përkthehet *mantello* (le falde del mantello), por shoqërohet me disa shpjegime rreth kësaj fjale, duke theksuar se është një lloj manteli që ka disa karakteristika të tij e që në tekst quhet *dollame*. Një fjalë tjetër që kërkon vëmendje është fjala *varrë*, që gjendet në vargun *Por, si i a lidhen varrët e shtatit*, e që vjen e përkthyer në variantin *appena gli ebbero fasciate le ferite*. Pra, *varrë* është përkthyer *ferite*, që do të thotë *plagë*. Por duke konsideruar kontekstin *plagë* nuk mund të jetë e njëjtë dhe as sinonim i *varrës*, fjalë e përzgjedhur jo rastësisht nga Fishta. Sipas fjalorit të Tahir Kolgjinit fjala *varrë* shpjegohet në këtë mënyrë: “simbas kanunit kur plumbi tjetrin nuk e merr në ndonjë vend të rrezikshëm, nuk i sjell shëmtim në ndonji vend, si në pjesët e ndryshme të fytyrës... quhet varrë. Varra është baraz me ¼ e gjakut, ndërsa plaga me 2/4 e gjakut”⁷.

Mendoj se kërkon një përkthim më të saktë edhe vargu i mëposhtëm, i cili përçon një fenomen tipik shqiptar, që mund të mos jetë i njëjtë me atë të një kombi tjetër. Në traditën tonë familjarë, burri ishte figura qendrore e familjes, pika e referimit dhe personi i vetëm që mbante përgjegjësi për fatin e gjithë familjes e prandaj konsiderohej si “kulmi i shpis”, trari që mban gjithë arkitekturën. Varianti në italisht duket më i zbehtë, nuk e ka as forcën dhe as ngjyrën e origjinali, e për

⁶ A. Plasari, *Fishta i dashuruari*, Marin Barleti, 1996, Tiranë, f. 7.

⁷ T. Kolgjini, *Shpalime rreth Lahutës*, Istanbul, 1969, f. 276.

Disa elemente etnokulturore të Lahutës në variantin italisht

më tepër nuk e përçon plotësisht atë që është pjesë e rëndësishme e mentalitetit shqiptar, humbjen e burrit dhe babait.

qi ka mbetë sod qyqe n'votër,
sod qi **kputë i asht kulmi i shpis**

rimasta derelitta al **focolare**
che oggi **le venne spento dal destino**

Përsëri një varg tjetër “*Jam ndërmjet!*” atbotë vikati që vjen i përkthyer në formën *Oso Kuka si affretta ad interporsi / con la grande persona in mezzo a loro*” do të përbënte një fenomen më vete që duhet kuptuar vetëm nëse i referohemi mentalitetit të kanunit, sipas të cilit *ndërmjetësi* shfrytëzon të gjithë autoritetin dhe nderin e tij derisa merr përsipër të gjithë përgjegjësinë e çështjes në fjalë.

Mund të sjellim një sërë shembujsh të cilët dëshmojnë qartë se Koliqi përpiket të sjellë një përkthim që përqendrohet më shumë tek riformulimi i mesazhit, tek përmbajtja dhe jo tek fjalët e veçanta e tek ngarkesa që shfaq secila prej tyre. Në disa raste ai mundohet të bëjë një sintezë të asaj që do të kërkonte shpjegime shumë më të gjata se vetë vargu. Për shembull:

- | | |
|---|---|
| 1. se ç'm'i bajn t'gjith tungjatjeta | come si levan tutti ad ossequirlo |
| 2. për kanù e besë e Fe | per le usanze dagli avi ereditate |
| 3. se për Din e për Iman | poiche ti giuro in nome del Profeta |
| 4. si për pushkë e besë të dhanme | sia per coraggio e per rispetto ai patti |

Këto fjalë janë nga më të rëndësishmet e traditës dhe kulturës shqiptare dhe këtë Koliqi e njeh mjaft mirë. Secila prej tyre përbën një kod më vete, një mënyrë të menduari e të sjelluri të ndryshëm nga ai i kombeve të tjerë, një element tipik shqiptar. Por kjo duket se është zgjedhja e Koliqit. Mënyra e zgjedhur prej tij për të përkthyer bën që elemente te caktuara, detaje a afumatura të zbehen dhe të mos u jepet rëndësi e veçantë. Duket qartë që këtë rëndësi e merr përmbajtja dhe ideja që përçon vargu. Mesazhi mbart vlerën më të madhe në këtë përkthim të Koliqit dhe ai duket i vendosur që këtë mesazh ta përçojë me çdo kusht edhe duke humbur ngjyra e forma e elemente të veçanta të stilit dhe të traditës.

BIBLIOGRAFI

- Atë Gj. Fishta, *Komb - Letërsi - Gjuhë*, Universiteti i Shkodrës, Studime shqiptare 6.
Atë Gj. Fishta, *Lahuta e Malcis*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2010.
A. Plasari, *Fishta i dashuruari*, Marin Barleti, Tiranë, 1996.
Fishta, *Poeti dhe mendimtari kombëtar*, Studime shqiptare 18, Shkodër, 2011.
Il Liuto delle Montagne (Episodio di Oso Kuka), Traduzione e note a cura di Ernesto Koliqi, Roma, 1973.
T. Çobani, *Lahuta e Malcis. Ngjizja mitologjike dhe fjalori i figurave mitologjike*, Botimet Fishta, Tiranë, 2012.
U. Eco, *Dire quasi la stessa cosa, Esperienze di traduzione*, Milano, Bonpiani, 2003.

